



KRYETARE

**Përshëndetja e Kryetares së KQZ-së, znj. Lefterije Luzi,
në Ditën Botërore të Zgjedhjeve.**

Tiranë, 04 shkurt 2016

I nderuar Zoti Ministër,

Të nderuar përfaqësues të Organizatave Ndërkombëtare dhe vendase,

Të dashur të rinj,

Në emër të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, ju falenderoj të gjithëve për pjesëmarrjen Tuaj në veprimtarinë që po organizojmë në kuadër të DITËS BOTËRORE TË ZGJEDHJEVE!

Falenderoj veçanërisht Ministrinë e Mirqënies Sociale dhe Rinisë, për bashkëpunimin në realizimin e kësaj veprimtarie, dhe kam kënaqësinë të theksoj se bashkëpunimi ynë institucional sot orientohet edhe në një rrugë të re, atë të edukimit zgjedhor të të rinjve, krahas atij për shmangien e barrierave për personat PAK në procesin e votimit.

Sot na bën bashkë DITA BOTËRORE E ZGJEDHJEVE, e cila celebrhet në shumë vende të botës që prej vitit 2005.

Ekspertët e zgjedhjeve nga e gjithë bota, vendosën që e enjtja e parë e Shkurtit të çdo viti të jetë “Dita Botërore e Zgjedhjeve”, si mesazh i rëndësishëm për forcimin

e proceseve demokratike në të gjithë botën, ku zgjedhjet e lira dhe të ndershme janë themeli i demokracisë.

Qëllimi i kësaj dite është përcjellja e mesazheve për:

- Forcimin e besimit publik në proceset zgjedhore;
- Informimin e publikut për arritjet dhe sfidat që lidhen me llojet e ndryshme të sistemeve të votimit;
- Sjelljen në vëmendje të politikës dhe udhëheqësve botërorë mbi rëndësinë e rolit të tyre në promovimin e kulturës demokratike;
- Ndikimin tek votuesit për herë të parë dhe votuesit e rinj me qëllim angazhimin e tyre për vlerat dhe proceset demokratike.

KQZ, për herë të dytë, celebron këtë Ditë kushtuar zgjedhjeve, duke bërë protagonistë të saj të rinjtë, dhe përfaqësues të grupimeve të tjera shoqërore, me qëllim sensibilizimin për rëndësinë e proceseve zgjedhore dhe rëndësinë e votës së lirë, si shprehje e vullnetit individual.

Idetë dhe mendimet tuaja, dhe sidomos përfshirja juaj në proceset zgjedhore, është kontribut i çmuar për zhvillimin e zgjedhjeve të lira, të ndershme dhe me standarte, kontribut i cili i bën shërbimin më të mirë forcimit të demokracisë në vend.

Rritja e standardeve të procesit zgjedhor, kërkon përfshirjen dhe kontributin e të gjithëve, veçanërisht të ju të rinjve. Jeni ju, që me pastërtinë e mendimeve tuaja, me energjinë dhe forcën tuaj rinore, dhe me angazhimin tuaj, mund dhe duhet të bëheni barriera të pakapërcyeshme për fenomenet negative që cënojnë VOTËN E LIRË!

Zgjedhjet janë proces dinamik dhe sfidues, jo vetëm për institucionin që organizon dhe administron ato, për ata që kandidojnë, por për të gjithë shoqërinë, e cila sfidohet për të dëshmuar kulturën e saj zgjedhore.

Shmangia e fenomeneve që çenojnë standartet e procesit zgjedhor si: indiferenca për të marrë pjesë në votim, votimi familjar apo ndikimi i vullnetit të zgjedhësit, kërkojnë angazhimin dhe bashkëpunimin në vijimësi të të gjithë aktorëve dhe faktorëve institucionalë e shoqërorë.

Edukimi zgjedhor i shtetasve, është mënyra më efektive në luftën ndaj këtyre fenomeneve dhe forcimin e kulturës zgjedhore tek votuesit e sotëm dhe të nesërm.

Në këtë kuadër, pjesë e rëndësishme e veprimtarisë së KQZ-së është realizimi i projekteve edukuese zgjedhore, të përgjithshme dhe për grupimet shoqërore me specifika të veçanta si për pakicat kombëtare, zgjedhësit me aftësi të kufizuara, sikundër është ky projekt që do të prezantohet sot i hartuar për komunitetet Rome.

Falenderoj Institutin e Kulturës Rome, me të cilin KQZ ka bashkëpunuar edhe për zgjedhjet lokale të 2015, dhe në simbolikën e kësaj Dite të rëndësishme, institucionalizohet përmes nënshkrimit të një marrëveshje bashkëpunimi.

Duke e përmbyllur, ritheksoj se idetë dhe angazhimi juaja, janë kurdoherë i mirëpritur nga KQZ si kontribut i çmuar për atë që mund të bëhet më mirë në respekt të VOTËS SË LIRË, TË FSHEHTË DHE TË BARABARTË.

Ju faleminderit!